



Planuar / Doretuar Punje/Prodato Received/Delivered	20.02.2023	viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/ISHOK	1938/2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OF THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1249/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1249/2022 të datës 23.12.2022 të parashtruar nga ankuesi rr."Anton Çeta" Lipjan kundër organit të punësimit Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet e pa bazuar ankesa A.nr.1242/2022 e datës 23.12.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.02/22 i datës 06.12.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, lidhur me masën disiplinore të shqiptuar ndaj ankuesit.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit [] punësuar sipas shkresave të lëndës në pozitën Analistë i Lartë Buxhetit Komunal në kuadër të Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve sipas Akt Emërimit të datës 14.04.2018.

Mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejt me datë 07.11.2022 nëpërmjet shkresës me nr. protokolli 2518/2022 ka bërë iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit lidhur me shkelje të rëndë të detyrave të punës për shkak mos trajtimit adekuat të shkresës së Komunës së Suharekës të datës 05.10.2022 me nr pro. 824-2/2022.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve ka nxjerr vendim me Nr.02/22 më datë 06.12.2022 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar Masën Disiplinore "Ndalim i Ngritjes në Detyrë duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë dy (2) vjeçare".

Ankuesi i pakënaqur ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimin ankimor kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve me Nr.02/22 të datës 06.12.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.01.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, ndërsa Këshilli më datë 24.01.2023, me numër protokolli 740/2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, me shkresat e bashkangjitura.

Për shkak të specifikave të lëndës, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 02.02.2023 ka nxjerr Vendim VK/2023 me të cilin ka bërë zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës së ankuesit për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. Protokolli 8390/2022 të datës 23.12.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Material shtesë për ankesën e ankuesit me numër protokolli 8505/2022 të datës 28.12.2022; Vendim i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve me numër protokolli 2836/2022 të datës 06.12.2022; Kërkesë Bartjen e transferit e të hyrave vetanake me numër protokolli 824/2022 të datës 26.04.2022; Vendim Kuvendi i Komunës Suharekë me numër 01-Nr.016-12176 i datës 28.02.2022; Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2020 dhe 2021 në vitin fiskal 2022 e datës 13.04.2022; Tabela Realizimi i THV janar-31.12.2021 KK Suhareka të datës 19.04.2022; Lista e projekteve kapitale të cilat bartën nga viti fiskal 2020 dhe 2021 në vitin 2022 të datës 14.04.2022; Bartja e THV 2020 dhe 2021 në vitin fiskal 2022 të datës 13.04.2022; Kërkesë për ekzekutimin e pjesërishëm të vendimi me numër protokolli 824-1/2022 të datës 30.06.2022; Kërkesë për ekzekutimin e pjesërishëm të vendimit me numër protokolli 1574/2022 të datës 22.07.2022; Bartja e THV 2020 dhe 2021 në vitin fiskal 2022 të datës 18.07.2022; Lista e projekteve kapitale të cilat barten nga viti fiskal 2020 dhe 2021 në vitin fiskal 2022 të datës 15.07.2022; Kërkesë për bartjen e pjesërishëm të mjeteve të pashpenzuara të hyrave vetanake me numër protokolli 1574-1/2022 të datës 28.07.2022; Kërkesë për bartjen e pjesërishëm të mjeteve të pashpenzuara të të hyrave vetanake e datës 25.07.2022; Tabela për bartjen e THV nëpër kategori ekonomike sipas SIMFK-nga viti 2021 në vitin fiskal 2022; Kërkesë për ekzekutimin e pjesërishëm të vendimit Nr.824 të datës 26.04.2022 dhe vendimit 016-57283 të K.K. Suharekës i protokolluar me numër protokolli 824-2/2022 i datës 05.10.2022; E-mail nga [] për [] etj i datës 08.07.2022; E-mail nga [] për [] etj, i datës 22.06.2022; E-mail nga [] për [] i datës 21.06.2022; E-mail nga [] për [] etj, i datës 10.05.2022; E-mail nga [] për [] i datës 25.05.2022; E-mail nga [] për [] etj, i datës 18.05.2022; E-mail nga [] për [] i datës 17.05.2022; E-mail nga [] për [] i datës 20.07.2022; E-mail nga [] për [] i datës 20.07.2022; E-mail nga [] për [] i datës 15.07.2022; E-mail nga [] për [] etj, i datës 10.10.2022; E-mail nga [] për [] etj, i datës 14.10.2022; Tabela për bartjen e THV nëpër kategori ekonomike sipas SIMFK-nga viti 2021 në vitin

fiskal 2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] etj. i datës 22.11.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] etj. i datës 22.11.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 15.11.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 28.10.2022; E-mail nga S.E. për [redacted] i datës 28.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 28.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 28.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 28.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 28.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 14.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 31.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 31.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] datës 28.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 28.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 28.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 28.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 28.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 28.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 28.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 28.10.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokollit 481/2023 i datës 18.01.2023; Vendim me numër VK/2023 i datës 02.02.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokollit 740/2023 i datës 24.01.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] me numër protokollit 854/2023 i datës 25.01.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] etj. i datës 25.01.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] etj. i datës 25.01.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 23.01.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] datës 06.12.2023; Akt Emërimi i [redacted] i datës 14.04.2018; Përshkrimi i detyrave të punës- Formulari PDP i datës 17.02.2018; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 23.01.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 06.12.2022; Kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore me numër protokollit 25181/2022 i datës 07.11.2022; Vendim me 01-Nr-016-12176 i datës 28.02.2022; Kërkesë për ekzekutimin e pjesërishëm të vendimit me numër protokollit 1543/2022 i datës 18.07.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 14.10.2022; Vendimi me 01-Nr-016-57283 i datës 31.08.2022; Kërkesë për ekzekutimin e pjesërishëm të vendimit i datës 07.09.2022; Kërkesë për ekzekutimin e pjesërishëm të vendimit me numër protokollit 1515/2022 i datës 14.07.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 21.09.2022; E-mail nga [redacted] i datës 21.09.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] etj. i datës 08.07.2022; E-mail nga [redacted] për zyrtar kryesor financiar [redacted] i datës 22.06.2022; E-mail nga [redacted] shkresa me nr.824 i datës 22.06.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 21.06.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] I. etj. 10.05.2022; E-mail nga [redacted] i datës 25.05.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] etj. i datës 18.05.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 17.05.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 28.06.2022; E-mail nga [redacted] i datës 12.05.2022; E-mail nga [redacted] datës 10.05.2022; Kërkesë për ekzekutimin e pjesërishëm të vendimit me numër protokollit 1574/2022 datës 22.07.2022; Kërkesë: Bartje në transferin e të hyrave vetanake nga viti 2020 dhe 2021-2022 i datës 22.04.2022; Kontratë me numër protokollit 34184 i datës 17.06.2021; Kushtet e përgjithshme numri i kontratës; 624-21-2029-2-2-1/C633 pa datë; Kushtet e Veçanta numri i kontratës; 624-21-2029-2-2-1/C633; Kontratë numri i kontratës: 624-22-1897-5-2-1/C787 me numër protokollit 26704 e datës 06.05.2022; Kushtet e Veçanta numri i kontratës: 624-22-1897-5-2-1/C787; Deklaratë për kualitetin e punimeve i datës 06.05.2022; Vendim me 01-Nr.016-26862 të datës 06.05.2022; Kontratë publike kornizë me numër protokollit 56602 të datës 29.08.2022; Pjesa II. Përshkrimi i Çmimeve; Kushtet e veçanta Deklaratë për kualitetin e punimeve i datës 29.08.2022; 038 II. Përshkrimi i Çmimeve; Kontratë me numër protokollit 65095 të datës 13.09.2019; Deklaratë për kualitetin e punimeve i datës 13.09.2019; Kontratë me numër protokollit 21665 të datës 08.04.2021; Kushtet e Veçanta numri i kontratës: 624-20-5546-5-2-1/C594; Kontratë me numër protokollit 72332 të datës 72332 të datës 22.11.2022; Kushtet e Veçanta numri i kontratës: 624-21-9131-1-2-5/C738; Kontratë me numër protokollit 64346 të datës 14.10.2021; Kushtet e Veçanta numri i kontratës: 624-21-6567-5-2-1/C713; Kontratë me numër protokollit 54517 të datës 09.11.2020; Deklaratë për kualitetin e punimeve i datës 09.11.2020; Kontratë me numër protokollit 41681 të datës 27.06.2019; Kontratë Renovimi dhe Mirëmbajtja e Lapidarëve Nr. prokurimit 624-19-029-521/624-19-2575-5-2-1 të datës 27.06.2019; Aneks Kontratë -Punë -shitesë të datës 26.09.2019; Kontratë me numër protokollit 41681 të datës 27.06.2019; Kontratë me numër protokollit 6338 të datës 11.10.2021; Kushtet e veçanta numri i kontratës 624-21-6592-5-3-5/C702; Kontratë me numër protokollit 63070 të datës 04.09.2019; Kushtet e veçanta me Nr. i prokurimit 624-19-305-223/624-19-006

423 pa datë; Titulli i Kontratës-trajtimi i deponive Ilegale me numër protokolli 19818 të datës 03.06.2020; Deklaratë për kualitetin e punimeve i datës 03.06.2018; Kontratë me numër protokolli 60283 të datës 16.12.2020; Kontratë Publike kornizë me numër protokolli 53508 i datës 22.08.2018; Kontratë me numër protokolli 57627 i datës 02.12.2020; Deklaratë për kualitetin e punimeve i datës 02.12.2020; Kontratë me numër protokolli 58139 i datës 04.12.2020; Deklaratë për kualitetin e punimeve i datës 04.12.2020; projektimi Nr.i prokurimit:624-20-4943-2-2-3 të datës 28.09.2020; Kontratë Publike Kornizë me numër protokolli 53509 të datës 22.08.2018; Raporti i Analizave të Llogarive-Detajet- Viti Fiskal 2022- Periudha Fiskale :Gusht-Shtator; Qeveria e Kosovës -Ministria e Financave, Punës dhe transferove Thesari i Kosovës-SIMFK 2022; Kontratë me numër protokolli 30357 të datës 23.05.2022; Deklaratë për kualitetin e punimeve i datës 23.05.2022; Paramasa për kryerjen e punëve-Ndërtimi i objektit të ri të Sallës së EDF pran Sh.F.M.U. "Dëshmoret e Grelkocli "-Grelkoc pa date; E-mail nga [redacted] për [redacted] të datës 02.11.2022; Shqyrtimi i kërkesës së komunës së Suharekës për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara nga vitit 2020-2021 në vitin 2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 31.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] datës 31.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] datës 31.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 31.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 31.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 28.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 28.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 28.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 28.10.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 13.10.2022; E-mail nga [redacted] i datës 07.10.2022; E-mail nga [redacted] i datës 03.10.2022; E-mail nga [redacted] datës 30.09.2022; E-mail nga [redacted] etj. i datës 30.09.2022; E-mail nga [redacted] etj. i datës 20.09.2022; E-mail nga [redacted] etj. i datës 02.09.2022; E-mail nga [redacted] etj. i datës 26.08.2022; E-mail nga [redacted] etj. i datës 25.05.2022; E-mail nga [redacted] etj. i datës 21.09.2022; E-mail nga [redacted] i datës 25.05.2022; E-mail nga [redacted] etj. i datës 18.05.2022; E-mail nga [redacted] të datës 17.05.2022; E-mail nga [redacted] i datës 21.06.2022; E-mail nga [redacted] etj. i datës 10.05.2022;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit Nexhmedin Thaqi, është e pa bazuar, sepse:

Kolegji fillimisht ka trajtuar inicimin e procedurës disiplinore dhe ka konstatuar se iniciimi është bërë bazuar në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht nenit 48 paragrafi 7 i cili përcakton se "7. Procedura disiplinore fillon pa vonesë, me marrjen në dijeni për një shkelje disiplinore, por jo më vonë se brenda një afati dyvjeçar (2) nga data e kryerjes së shkeljes. Në rastin e shkeljeve të rënda, që mund të rezultojnë në marrjen e masës disiplinore të largimit nga Shërbimi Civil, afati është tetë (8) vjet" si në harmoni me nenin 7 të Rregullores Nr.11/2020 për Procedurën Disiplinore dhe të Ankesave për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se" 1. Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë në rastet kur vihet në dijeni të një pretendimi për shkelje disiplinore, nëpërmjet ankesave nga qytetarët apo institucione jashtë strukturave të institucionit, e vlerëson paraprakisht atë. 2. Procedura disiplinore fillon pa vonesë, me marrjen në dijeni për një shkelje disiplinore brenda afateve të përcaktuara në nenin 48 paragrafin 7 të Ligjit.

Kolegji ka trajtuar pretendimet e ankuesit lidhur me pikën për të cilën është shqiptuar masa disiplinore veçmas sa i përket shkresës së Komunës së Suharekës të datës 05.10.2022 me nr.prot 824-2/2022 për bartjen e të hyrave vetanke në bugjetin komunal. Ankuesi pretendon se ka bërë komunikime me imel me datë: 14.10.2022 dhe përmes telefonit me Zyrtarin Kryesor Financiar të Komunës së Suharekës lidhur me bartjen e bugjetit nga të hyrat vetanke në Komunën e Suharekës, dhe të njëjtën kërkesë e ka refuzuar si jo të kompletuar, dhe sipas pretendimeve të ankuesit, këta të fundit nuk kanë bërë plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, Kolegji ka analizuar shkresat dhe imellat e komunikimit në mes të ankuesit dhe ZKF të Komunës së Suharekës, dhe ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i MFTP drejtë dhe saktë ka konstatuar gjendjen juridike dhe faktike, sepse ankuesi edhe sipas Kolegjit nuk ka ofruar dëshmi se ka pasur komunikim të saktë nuk ka kërkuar cilat kontrata mungojnë, apo cilat kontrata shtesë duhen ofruar në mënyrë që lënda të plotësohet dhe të procedohet me kohë, sepse ankuesi në pozitën të cilën e mban sipas përshkrimit të punës "është i obliguar ti ofroj ndihëm dhe këshilla Organizatave bugjetore, por që sipas shkresave të lëndës ankuesi këtë nuk e ka bërë.

Si pasoj e mos veprimit të kujdesshëm dhe në përputhje me aktet ligjore në fuqi, Kolegji konstaton se ankuesi ka shkaktuar pasojë me veprimin ose mos veprimin e tij, sepse për shkak të mos trajtimit të shkresës së lartshënuar është shkaktuar pasoja që Komuna e Suharekës nuk ka mundur të shfrytëzoj me kohë të hyrat vetanake, prandaj veprimi i ankuesit ka bërë shkaktimin e pasojës. Në këtë mënyrë ankuesi ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht nenin 25 i cili përcakton se "1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike"

Rrjedhimisht ngase u tha më lartë Kolegji, konstaton se Komisioni Disiplinor drejtë ka konstatuar se ankuesi ka ra ndeshë me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht me neni 45 i cili përcakton se "1. Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit", sepse në veprimet e ankuesit manifestohen elementet e qarta të përgjegjësisë sipas dispozitës së lartshënuara.

Ndërlidhur me këto fakte, Kolegji lidhur me individualizimin e masës së ankuesit i është referuar nenit 50 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se "1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit. 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer", sepse ankuesi sipas shkresave të lëndës ka edhe dy vërejte në fuqi të cilat ende nuk janë të shuara.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1249/2022

Çlirim ZEKA

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Financave Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve ;
- Arkivit të KPMSHCK-së

